



FTESE PER OFERTE

Fondacioni SOS Fshatrat e Fëmijëve është organizatë joqeveritare e përkujdesjes sociale e dedikuar për përkrahjen e fëmijëve të braktisur dhe në nevojë, pa marrë parasysh etninë, kombësinë dhe besimin fetar.

SOS Fshatrat e Fëmijëve janë të interesuar për një sallë të mjaftueshme, për realizimin e trajnimeve, seminareve, konferencave si dhe për aktivitete tjera. Kjo sallë do të përdoret për të përmbushur aktivitetet e planifikuara gjatë vitit që do të ofrojnë mundësi për zhvillim profesional të punonjësve, shkëmbimin e përvojave me partnerë dhe bashkëpunëtorë, zgjerimin e partneriteteve, promovimin e punës së organizatës etj.

Me këtë rast ju bëjmë Ftesë për Ofertë sipas specifikacionit në vijim:

LOT 1

- Sallë trajnimi e cila ka kapacitet për 20-30 persona (Salla të jetë e përshtatshme për punë në grupe, session plenar apo format tjetër)
- Ofrimi I ujit (2 shishe të vogla) për pjesëmarrës gjatë trajnimit
- Ofrimi I kafes (3 kafe) për pjesëmarrës gjatë pauzave
- Dreka për pjesëmarrës (ju lutem të bashkangjisni menynë të cilën e ofroni)
- Salla duhet të ketë ndricim të mirë dhe të ketë qetësi

LOT 2

- Sallë për konferenca, prezentime, aktivitete të ndryshme e cila ka kapacitet për 50-150 persona
- Ofrimi I ujit (2 shishe të vogla) për pjesëmarrës gjatë konferencës
- Ofrimi I kafes (3 kafe) për pjesëmarrës gjatë pauzave
- Dreka për pjesëmarrës (ju lutem të bashkangjisni menynë të cilën e ofroni)
- Salla duhet të jetë në dispozicion 2 deri 4 herë në vit
- Salla duhet të ketë ndricim të mirë dhe të ketë qetësi

Salla duhet të ketë pajisjet si:

- **Projektor,**
- **Tabelë për mbajtjen e letrave (flipchart)**
- **Mundësi për printim (e preferuar)**

Salla duhet të jetë në Prishtinë ose në periferi.

Dokumentet e nevojshme:

1. Qertifikata e nr. Fiskal/ NUI
2. Qmimet e kuotuar në euro pa tvsh
3. Oferta financiare e ndarë me cmime për: sallë, ujë, kafe dhe drekë
4. Oferta financiare e nënshkruar ose me llogo zyrtare

Kriteret për përzgjedhjen e ofertës më të mirë do të jenë si në vijim:

1. Përmbushja e specifikacionit sipas Ftesës për Ofertë
2. Pas plotësimit të kriterëve -Çmimi më i lirë

Vlefshmëria e Ofertës duhet të jete 20 dite nga data e mbylljes se Fteses per Oferte.

Jeni të lirë të ofertoni për një Llot ose për të dy Llotet duke i derguar ofertat ndarazi të emëruar LOT1 dhe LOT2 sipas Lot-it përkatës

Ofertuesi i përzgjedhur, para nënshkrimit të kontratës duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës dhe pronari i biznesit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe vërtetimin tatimor

Ofertuesit e interesuar duhet t'i dorëzojnë dokumentet dhe ofertën e mbyllur në pliko (zarf) 2 kopje të nënshkruara nga përfaqësuesi ligjor dhe të shënuara me kodin: “Oferta për Sallë”. Ju lutem në pliko të cekni edhe për cilin Llot ofertoni: Llot1 apo Llot2. Ju mund të ofertoni edhe për të dy Llotet. Ofertat duhet të dorëzohen deri me datën: 18.03.2020 në zyrat e SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, në adresën Velania 1 Tetori p.n. Prishtinë Cdo ditë pune nga ora 09:00-15:00 Ofertat e pakompletuara dhe të dorëzuara me vonesë nuk do të shqyrtohen